



**UNIVERSITETI BUQËSOR I TIRANËS  
FAKULTETI I MJEKËSISË VETERINARE**

**RREGULLORE E FUNKSIONIMIT TË KLINIKËS SË  
KAFSHËVE NË FAKULTETIN E MJEKËSISË VETERINARE**

**MIRATOI**

**REKTORI**

**Prof. Dr. Bahri Musabelliu**

**Tiranë, 2019**

## **PJESA E PARË**

### **Neni 1**

#### **Kuadri ligjor**

Rregullorja e funksionimit të Klinikës së kafshëve në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare bazohet në:

- Ligjin Nr. 80/2015 «Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë», Neni 3 pika 1, pika 3 nënpikat a,b,c, Neni 95 pika 5 dhe Nenin 109 pika 1 nënpikat c, ç dhe pika 2 dhe 3.
- Statutin e Universitetit Bujqësor të Tiranës;

Sipas Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Institucionet e Arsimit të lartë, të ardhurat e realizuara nga shërbimet do të shpërndahen sipas meritës në Departamentet që ofrojnë këto shërbime. Bazuar në nenin 109 pika 2 dhe 3 të ligjit të arsimit të lartë të ardhurat e përfituara nga shërbimet, veprimtaritë kërkimore-shkencore, konsulencat, si dhe çdo e ardhur që realizohet nga veprimtaria ku merr pjesë personeli akademik do të ndahet ndërmjet personelit akademik dhe IAL-së, sipas rregullore së miratuar nga Bordi i Administrimit.

### **Neni 2**

#### **Objektivat e rregullores**

Rregullorja ka për qëllim të përcaktoj mënyrën e:

- a. organizimit dhe aktivitetit të Klinikës së kafshëve;
- b. zgjedhjes së drejtuesve dhe detyrat e tyre;
- c. angazhimit të studentëve dhe organizimin e mësimdhënies;
- d. bashkëpunimit me klinikat dhe stacionet veterinare;
- e. bashkëpunimit me organizatat veterinare në terren;
- f. kujdesit për bazën materiale (inventarin e mjeteve, paisjeve dhe furniturave veterinare) dhe çështje të tjera në lidhje me aktivitetin e Klinikës së kafshëve.

### **Neni 3**

#### **Detyrat e Klinikës**

- a. Klinika e Fakultetit të Mjekësisë Veterinare (FMV), ka statusin e klinikës universitare dhe shërben për realizimin e procedurave të ndryshme mjekësore e kirurgjikale tek kafshët e

shoqërimit (qen, mace, njëthundrakë), kafshët ekzotike e dekorative shtëpiake, kafshët bujqësore dhe ato të rritjes industriale (gjedhë, ruminantët e vegjël, derra, shpendë, peshq) si dhe kafshët e egra;

- b. Klinika përveç funksionit didaktik për përgatitjen e studentëve si mjekë veterinerë të ardhshëm, shërben edhe si njësi shërbimi ndaj të tretëve;
- c. Klinika është e hapur ndaj gjithë stafit akademik të Fakultetit për realizimin e punëve shkencore që janë në përputhje të plotë me legjislacionin për mbrojtjen dhe mirëqenien e kafshëve.

#### **Neni 4**

##### **Organizimi dhe aktiviteti i Klinikës**

- a. Klinika e kafshëve është njësi themelore organizative e Fakultetit të Mjekësisë Veterinare që ofron edukim praktik dhe klinik për studentët, shërbime ndaj të tretëve, kërkim shkencor si dhe edukim të vazhduar për anëtarët e shoqatave të ndryshme veterinarë;
- b. Drejtuesi kryesor i Klinikës (Përgjegjësi i Departamentit të Lëndëve Klinike), zgjidhet në pajtim me Rregulloren për zgjedhjen e autoriteve drejtuese në institucionete arsimit të lartë;
- c. Personeli akademik i Departamentit të Lëndëve Klinike dhe pjesëtarë të stafit akademik të Fakultetit që kanë orientim kliniko-praktik shërbejnë në më të shpeshtën 1 ditë pune në javë (dezhurn) në mbështetje të klinikës, në formë rotacioni, sipas një liste që shpallet në ambjentet e Klinikës çdo muaj. Pas ditës dezhurn, kur angazhohet mbi orarin zyrtar të punës, i jepet një (1) ditë pushim nga titullari i institucionit në përputhje me ligjin e Kodit të Punës në fuqi;
- d. Rastet klinike/kirurgjikale konsiderohen jo vetëm si element didaktik për formimin praktik dhe klinik të studentëve por dhe si një burim të ardhurash;
- e. Personeli akademik, ndihmës akademik dhe studentët janë të kushtëzuar të shfaqin një paraqitje dinjitoze me përparëse të bardhë ose veshje pune, sipas rastit, si dhe një fjalor etik.

#### **Neni 5**

##### **Specialistët dhe personeli ndihmës**

- a. Specialistët/teknikët dhe personeli ndihmës akademik punojnë nën mbikqyrjen dhe drejtimin e personelit akademik që ka praktikë mësimore ose që punon në mbështetje të klinikës (dezhurn);
- b. Në çdo rast klinik, gjatë realizimit të procedurave të ndryshme mjekësore tek kafshët, duhet të ketë bashkëpunim midis specialistëve, pa ndarje strikte-penguese për punën;

- c. **Etika e lartë, respektimi i hierarkisë dhe komunikimi dinjitoz** të jenë kushte parësore edhe në këtë nivel shërbimi;
- d. Në funksion të punës në Klinikë shërben edhe një sanitar(e)/pastrues(e) i/e cili(a) ka si detyrë parësore mbajtjen pastër të klinikës, në bashkëpunim edhe me studentët dhe stafin tjetër ndihmës-akademik;
- e. Specialistët/teknikët veterinar duhet që vazhdimisht të kontrollojnë dhe të plotësojnë materialet e konsumit ose furniturat veterinarë që përdoren gjatë orëve të mësimit (doreza, kalata, mbulesaetj.) si dhe të kontrollojnë sasinë e barnave dhe datën e skadimit të tyre në mënyrë që ato të ripërtrihen dhe plotësohen në kohë;
- f. Në rast se ka nevojë për medikamente ose pajisje specifike shtesë, stafi akademik dhe ai teknik që punon me studentët duhet të informojnë drejtuesin/menaxherin e klinikës në mënyrë të tillë që artikujt e lartpërmendur të mund të porositen në kohë;
- g. Specialistët/teknikët e Klinikës duhet të mbajnë të dhënat e punës, të mbajnë shënime dhe të plotësojnë formularët e porositjes për mallrat e nevojshme, të mbajnë libër plotësues dhe librin blerës për inventarin e vogël, një libër për medikamentet që i ka kaluar afati dhe të kryejnë detyra të tjera të dhëna nga drejtuesi/menaxheri i Klinikës;
- h. Personelit ndihmës akademik, pas ditës (dezurn) në mbështetje të Klinikës, kur angazhohet mbi orarin zyrtar të punës, i jepet një (1) ditë pushim nga titullari i institucionit në përputhje me ligjin e Kodit të Punës në fuqi.

## **Neni 6**

### **Studentët**

- a. Studentët zhvillojnë në Klinikë praktika mësimore në lëndët klinike sipas kurrikulës së FMV. Në Klinikë nuk lejohet qëndrimi i studentëve pa veshjen e bluzës së bardhë, ose veshjeve për kirurgji;
- b. Studentët e vitit të 4 dhe të 5-të, dy-tre studentë për secilin kurs, një ditë në javë duhet të jenë të përfshirë në punët e klinikës sipas një grafiku që shpallet në ambjentet e Klinikës;
- c. Studentët duhe ninkurajuar të jenë pjesëmarrës në çdo aktivitet të Klinikës, por nën mbikqyrjen dhe kujdesin e personelit akademik dhe ndihmës akademik;
- d. Paraqitja e jashtme e tyre duhet të jetë dinjitoze, detyrimisht me përparëse të bardhë.

## **Neni 7**

### **Menaxhimi i Klinikës dhe marrëdhëniet financiare**

- a. Klinika funksionon në bazë të një kase fiskale me NIPT sekondar dhe/ose konto bankare të veçantë për FMV-në;

- b. Inventari i medikamenteve dhe hyrje-daljet e tyre, të ardhurat, procedurat tatimore dhe fiskale, raportet financiare, ndarja e bonuseve financiare etj., menaxhohen nga menaxheri financiar i Klinikës;
- c. Menaxheri përkujdeset që punët e përditshme të Klinikës të funksionojnë siç duhet, duke i lejuar personelit akademik dhe atij ndihmës të jenë të fokusuar vetëm në punët veterinare;
- d. Personeli akademik dhe ndihmës akademik që përfshihen në realizimin e procedurave të ndryshme mjekësore në kafshë të ndryshme, mbështetur në të ardhurat e siguruar nga ofrimi i shërbimeve të përcaktuara në shtojcat aneks të kësaj rregulloreje shpërblehen në fund të muajit me një bonus financiar.
- e. Referuar në shtojcat aneks të listës së cmimeve të shërbimeve të kësaj Regullore, 40% e të ardhurave nga kryerja e çdo shërbimi i kalojnë personelit akademik të përfshirë në zgjidhjen e rastit, 40% përdoren për blerje medikamentesh dhe freskim aparatash për Klinikën dhe 20% kalojnë në llogarinë bankare të UBT-së;
- f. Menaxheri i Klinikës në bazën e të ardhurave të Klinikës dhe buxhetit të shtetit, në zbatim të ligjeve dhe rregulloreve në fuqi, sa herë që është e nevojshme, sipas porosive dhe kërkesave të specialistëve, në bashkëpunim me Drejtuesin e Klinikës duhet të sigurojë blerjen e medikamenteve, biopreparateve, kiteve të shpejta laboratorike etj., të cilat janë në funksion të punës së përditshme të klinikës, duke mos krijuar mungesa që pengojnë punën.

## **Neni 8**

### **Përkujdesja për pajisjet dhe instrumentat**

- a. Personeli akademik dhe ndihmës akademik/teknik që punon në Klinikën e fakultetit duhet të tregojnë kujdes për mirëmbajtjen e pajisjeve dhe instrumentave që shërbejnë për diagnostikimin dhe trajtimin e kafshëve të ndryshme;
- b. Studentëve u lejohet të punojnë me pajisjet dhe mjetet e tjera teknike në pronësi të Klinikës vetëm në prani dhe nën mbikëqyrjen e personelit mësimdhënës dhe teknik të autorizuar;
- c. Specialistët/teknikët veterinar dhe punonjësit e shërbimit duhet të raportojnë çdo trajtim të paautorizuar të pajisjes, si dhe dëmtimet eventuale të shkaktuara nga trajtimi i tillë;
- d. Specialistët/teknikët veterinar duhet të pastrojnë pajisjet siç duhet pas përdorimit dhe ta ruajnë atë në hapësirën e ofruar.

## **Neni 9**

### **Ambjentet e Klinikës**

- 1. Ambjentete klinikës së kafshëve të shoqërimit përbëhen nga:
  - a. dhoma e recepsionit me një ambient estetik pritje për klientët dhe database elektronike e kartotekë, dhoma e ekzaminimit të kafshëve menjëherë pas recepsionit;

- b. dhoma pre-kirurgjikale me lavamanet ku përgatitet stafi për ndërhyrje kirurgjikale;
  - c. salla e kirurgjisë dhe ambjenti më vehte ku qëndrojnë kafazët për kafshët që rikuperohen pas kirurgjisë ose janë në monitorim ose në procedure mjekimi. Mjedisi ku qëndrojnë kafazet, shërben edhe si vend lavanderie për veshjet e personelit dhe batanijeve që i shtrohen kafsheve;
  - d. garderobera për studentët – me dalje edhe nga korridori i godinës.
2. Ambjenti ku trajtohen kafshët e mëdha përbëhet nga:
- a. Salla ku qëndron stativi për kafshët e mëdha dhe tavolina pneumatike për njethundrakët;
  - b. Zyra e specialistit të sëmundjeve të kafshëve ripërtypëse;
  - c. Ambjenti i jashtëm përreth kësaj godine.
3. Dhoma e recepsionit të klinikës së kafshëve të shoqërimit ku realizohen të gjitha pritjet, kontaktet dhe pagesat me pronarët e kafshëve do të shërbejë si recepsion regjistrimi për kafshët e specieve të tjera.
4. Në funksion të Klinikës së Fakultetit janë laboratorit diagnostik (hematologji, biokimi, endokrinologji, virologji [teste të shpejta], parazitologjisë [teste dhe procedura të shpejta], bakteriologji-mykologji [teste të shpejta], histopatologjisë [teknika të shpejta]) si dhe kabineti i imazherisë (Departamenti i Lëndëve Paraklinike).

### **Neni 10**

#### **Puna në terren**

- a. Pas punës në fermë, personeli akademik mësimor dhe specialistët duhet të hedhin shënimet në mënyrë të rregullt dhe me ndërgjegje për punën me kafshët në terren.
- b. Pas kthimit nga puna në terren, teknikët veterinarë janë të detyruar të hedhin të gjitha të dhënat në regjister dhe kompjuter në baza ditore dhe javore, nqs nevojitet dhe në fund të një semestri të hartojnë raporte statistikore për numrin, llojin e kafshëve dhe vendet ku kanë qenë;
- c. Personeli akademik mësimdhënës dhe personeli jo-mësimdhënës që punojnë në terren marrin shpërblime të përcaktuara sipas kësaj rregulloreje.

### **Neni 11**

#### **Orari i aktivitetit në Klinikë**

- a. Orari i realizimit të aktivitetit në Klinikë është 8.00 – 16.00, nga e hëna në të premte. E shtuna dhe e djela, me përjashtim kur ka raste që mjekimi nuk duhet ndërprerë, janë pushim;

- b. FMV brënda një afati 1-3 vjeçar, pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, synon arritjen e mbulimit me shërbime mjekësore 24 orë në 7 ditë të javës, duke aktivizuar shërbimin në mbështetje të klinikës (dezhurn) mbi orarin zyrtar.

## **Neni 12**

### **Funksionimi i Klinikës**

- a. Tarifat e shërbimeve në Kliniën e Fakultetit të Mjekësisë Veterinare si qendër unike e edukimit veterinar, reflektojnë nivelin aktual të çmimeve të tregut veterinar privat;
- b. Tarifat e shërbimeve, pjesë e shtojcës aneks të kësaj Rregulloreje, për çdo specie janë transparente, të afishuara dukshëm në ambjentin e recepsionit të Klinikës dhe i bëhen të ditura çdo pronari kafshe shoqërimi ose fermeri para fillimit të kryerjes së shërbimeve. Tarifat janë objekt indeksimi dhe përditësimi. Në varësi të kërkesës, tregut dhe nivelit të inflacionit, mund të ndryshojnë, pas miratimit të ndryshimit;
- c. Kafshët që ekzaminohen, mjekohen apo i nënshtrohen ndërhyrjeve kirurgjikale, regjistrohen në librin e klinikës dhe në një database në recepsion si dhe ju hapet kartela individuale;
- d. Për ndërhyrjet kirurgjikale me anestezi të përgjithëshme apo kryerje eutanazie, pronari i kafshës duhet të firmosë një formular tip;
- e. Personeli akademik, specialist i rastit, në rastet e kafshëve të referuara nga klinika të tjera të mjekëve veterinerë privat, pas vendosjes së diagnoses dhe përcaktimit të mjekimit/ndërhyrjes kirurgjikale, në varësi të rastit dhe largësisë nga klinikat e FMV, mund tju sugjeroj pronarëve që shërbimet e tjera në vijim ti kryejnë tek mjeku veteriner që i ka referuar;
- f. Stafi akademik së bashku me stafin ndihmës duhet të orientojnë çdo rast drejt zgjidhjes optimale, nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë me laboratorin diagnostik, kabinetin e imazherisë dhe laboratorin e patologjisë, sëbashku me titullaret e lëndëve që kanë lidhje;
- g. Inventari i Klinikës kryhet çdo vit sipas rregullores së Universitetit, me mbikqyrjen e menaxherit financiar të klinikës. Inventari i medikamenteve duhet të përditësohet 1 herë në muaj. Për çdo medikament të harxhuar të pasqyrohen shënimet përkatëse, të firmosura nga mjeku veteriner që përdor medikamentin;
- h. Çdo punë e kryer në klinikë duhet të pasqyrohet e saktë dhe e detajuar në një regjister tip që tregon edhe pagesën e klientit. Regjistri të firmoset në fund të ditës nga mjeku veteriner që kryen shërbimin dhe në fund të çdo muaji të kundërfirmoset nga Drejtuesi i Departamentit të Lëndëve Klinike;
- i. Të gjitha të dhënat e përftuara në klinikë, rezultatet e testeve diagnostike, mjekimeve, fotografitë etj., janë pronë ekskluzive e FMV/UBT (stafit akademik) dhe në asnjë rast nuk lejohet të tjetërsohen;

- j. Pastërtia në ambjentet e Klinikës duhet të jetë shembullore nën moton “nëqoftë se ka kohë për të ndenjtur, ka kohë për të pastruar”;
- k. Kujdes i veçantë duhet treguar për marrjen e masave parambrojtëse ndaj sëmundjeve të transmetueshme nga kafshët tek njerezit apo nga kafshët tek kafshët, si dhe depozitimit e asgjësimit të mbetjeve në klinikë;
- l. Çdo procedure veterinare me kafshët e rrugës duhet të kryhet në përputhje të plotë me rregullat e mjekësisë së strehimoreve “shelter medicine”, duke mos u pajtuar në asnjë rast me asnjë formë të abuzimit me kafshët ose kryerjes së viviseksionit;
- m. Stafi i Klinikës kujdeset për shëndetin e kafshëve të laboratorit të Fakultetit;
- n. Stafi akademik i përfshirë në punët e Klinikës, me praninë edhe të studentëve të interesuar, organizojnë në Klinikë konsultat e mëngjesit të rasteve të paraqitura;
- nj. Rastet atipike interesante prezantohen edhe në nivel departamenti.

**Drejtuesi i Departamentit të Lëndëve Klinike**

**Prof. Dhimiter Rapti**

**Dekani**

**Prof. Rezart Postoli**